

**Deri te:**

**Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të  
Tetovës**

Në bazë të vendimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës, me nr.19-369/2 nga mbledhja e mbajtur me datën 27.11.2020, për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull: “Ndikimi i forcës eksplozive në efikasitetin e rezultateve në shtytjen e gjyles”, të kandidatit Mr. Sc. Agron Thaçi, Komisioni në përbërje të: Prof.Dr. Fadil Rexhepi - Kryetar, Prof.Dr.Hynor Kica-anëtar, Prof.Dr. Haki Ismaili-anëtar, Prof.Dr. Agron Ademi-anëtar dhe Doc.Dr.Astrit Iseni-anëtar, pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike i paraqet këtë

**RAPORT**

**Për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës**

**Të dhënat biografike të kandidatit:**

Agron Thaçi ka lindur në fshatin Llapushnik të komunës së Glllogocit më: 02.01.1983, ku edhe e ka përfunduar shkollën fillore. Shkollën e mesme, drejtimi Mjekësi e Përgjithshme e ka kryer në shkollën e mesme “Dr.Ali Sokoli” në Prishtinë, paralelja e ndarë në Glllogoc. Ndërsa fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportive e ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës në vitin 2006. Në po të njëjtin vit ka regjistruar sudimet pasdiplomike (Master), në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportive në Universitetin e Prishtinës, të cilat i ka përfunduar në vitin 2009, dhe merr titullin Master i Shkencave Sportive.

### **Përvoja personale:**

Që në moshë të re është marr me futboll, dhe ka qenë aktiv në ekipin KF"Gryka" nga Llapushniku për disa vite me radhë, e më pastaj ka qenë trajner futbollit me grupmoshat e reja gjithashtu për disa vite me radhë. Në vitin 2013 ka themeluar klubin e volejbollit "Drenasi" për meshkuj, ku është angazhar si trajner i këtij klubi për 5 vite me radhë. Gjatë kësaj kohe ka përfunduar me sukses kursin për trajner të volejbollit të organizuar nga Federata Ndërkombëtare e Volejbollit (FIVB).

Që nga viti 2006 punon si profesor i Edukimit Fizik, punë kjo të cilën e vazhdon edhe sot e kësaj dite. Aktualisht punon si profesor në shkollën e mesme profesionale "Fehmi Lladrovci" në Glllogoc.

Është anëtar dhe themelues i organizatës "Qendra për senzibilizimin e të rinjëve në sport", me të cilën ka realizuar disa projekte.

Në vitin 2016 ka regjistruar studimet e doktoraturës në Univrsitetin e Tetovës, në Fakultetin e Kulturës Fizike – drejtimi Kineziologji.

Ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore brenda dhe jasht vendit, dhe gjithashtu ka të publikuara një numër të konsiderueshëm të punimeve shkencore.

### **Punimet e publikuara në revistat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare:**

1. **Agron Thaqi , Bylbyl Sokoli, Isa Asllani (2018).** Antropometric and motor characteristics of the kosovo superleague midfielders in football. UDC 796.332.071.2:572.087.1(497.115).
2. **Sokoli Bylbyl, Miftari Florian, Thaqi Agron (2018).** Comparative analysis of motoric abilities between two groups of football referees from Kosovo. Journal of Education, Health and Sport.8(8):131-146. eISSN 2391-8306.
3. **Agron Thaqi , Bylbyl Sokoli (2019).** Factorial structure of the motoric abilities of first and second league soccer players in kosovo. European Journal of Physical Education and Sport Science. ISSN: 2501 - 1235 ISSN-L: 2501 – 1235.



4. Differences Between Motor Abilities of First and Second League Soccer Players in Kosovo
5. **Agron Thaqi, Bylbyl Sokoli, Isa Asllani, Jetmir Metaj (2019).** Relations of morphological characteristics and motor abilities in u-15 soccer players.UDC:796.332.012.14572.087.1(497.115)
6. **Agron Thaqi , Bylbyl Sokoli (2019).** Differences Between Motor Abilities of First and Second League Soccer Players in Kosovo. Eurasian Journal of Sport Sciences and Education Vol. 1, Issue 1, E-ISSN: 0000-0000.
7. **Milaim Berisha, Agron Thaqi (2020).** Normative Values for Physical and Psycho-Motor Characteristics in Children Aged 8-10 in Kosovo and Selection of Sports Talents Through the Psychomotor Norms.
8. **Agron Thaqi ,Milaim Berisha, Shkumbin Hoxha(2020).** The effect of plyometric training on the power-related factors of children aged 16 years-old. Progress in Nutrition 22(2):e2020004, DOI: [10.23751/pn.v22i2-S.10441](https://doi.org/10.23751/pn.v22i2-S.10441).
9. **Shkumbin Hoxha, Milaim Berisha, Agron Thaqi. (2020).** Analysis of some performance parameters and determination of the norm values in Kosovo First League goalkeepers.

Tema e disertacionit të doktoraturës me titull: **Ndikimi i forcës eksplozive në efikasitetin e rezultateve në shtytjen e gjyles**, ka për qëllim vlerësimin e efekteve të veprimtarisë stërvitore-eksperimentale, e orientuar në përsosjen e bazave për zhvillimin e treguesve të forcës eksplozive. Në studim janë vërtetuar dallimet ndërmjet grupit eksperimental (GE) dhe grupit të kontrollit (GK) dhe ndikimi i disa faktorëve në rritjen e rezultateve teknike të shtytjes së gjyles. Pra, përmes aplikimit të një programi të veçantë stërvitor me një grup nxënësish vërtetohen dallimet në mes të grupit eksperimental dhe grupit të kontrollit në hapësirën morfologjike dhe motorike si dhe në suksesshmërinë e ekzekutimit të shtytjes së gjyles.

Në **Hyrje** të këtij punimi autori ka sqaruar aspektet mësimore-stërvitore, duke pas për qëllim rritjen e treguesve të forcës, posaçërisht forcës shpërthyes (eksplozive) dhe formave të tjera të shfaqjes së saj, si dhe lidhjet reciproke ndermjet këtyre aftësive motorike me rezultatet atletikore. Poashtu autori ka trajtuar historikun e shtytjes së gjyles

Në mungesë të hulumtimeve të duhura të kësaj moshe dhe të kësaj lëmie në Kosovë, autori ka përzgjedhur popullatën e të rinjëve të moshës 16 vjeçare të gjinisë mashkullore.

Pra ky studim ka për qëllim që përmes aplikimit të një programi të veçantë stërvitor me një grup nxënësish të vërtetohen dallimet në mes të grupit eksperimental dhe grupit kontrollues në hapësirën morfologjike dhe motorike si dhe në suksesshmërinë e ekzekutimit të shtytjes së gjyles dhe gjithashtu në këtë pjesë autori ka sqaruar synimet e pjesëshme të hulumtimit.

Në **kapitullin e parë** – është paraqitur korniza teorike e punimit. Autori fillimisht ka shtjelluar analizën e strukturës lëvizore të shtytja e gjyles (varianti shkollor), duke elaboruar fazat e shtytjes së gjyles veç e veç. Më pastaj ka shtjelluar analizën biomekanike të strukturës lëvizore të shtytja e gjyles, ku ka shpjeguar faktorët biomekanik të cilët ndikojnë në suksesshmërinë e shtytjes së gjyles. Në vijim autori ka shpjeguar nocionet bazë, fillimisht definimin e hapësirës antropometrike-morfologjike, më pastaj ka shpjeguar strukturën e aftësive motorike, siç janë: forca, qëndrueshmëria, shpejtësia, agjiliteti, koordinimi, fleksibiliteti, drejtpeshimi etj. Poashtu në këtë kapitull janë pasqyruar disa hulumtime të autorëve të ndryshëm që kanë të bëjnë me ndikimin e karakteristikave morfologjike dhe aftësive motorike të atletët e shtytjes së gjyles.

Në **kapitullin e dytë** – autori ka përcaktuar lëndën e hulumtimit, e sila përfshin organizimin, përmbajtjen, zbatimin praktik dhe vlerësimin e veprimtarisë stërvitore-eksperimentale në zhvillimin e forcës shpërthyes me qëllim të rritjes së rezultateve teknike të shtytjes së gjyles. Në qëllimin e hulumtimit bëhet vlerësimi i efekteve të veprimtarisë stërvitore-eksperimentale, e orientuar në përsosjen e bazave për zhvillimin e treguesve të forcës eksplozive dhe dallimet e grupit eksperimental (GE) dhe grupit kontrollues. Në hipotezat e hulumtimit janë përfshirë pesë hipoteza, ndërsa në metodologjinë e hulumtimit është përfshirë mostra e entiteve prej gjithsej 220 nxënës vullnetar (meshkuj) të shkollës së mesme “Fehmi Lladrovci” të komunës së Glogocit (Kosovë) të moshës 16 vjeçare ( $\pm 6$ muaj).



Nëpërmjet aplikimit të metodës së rastit, mostra prej 220 nxënësve, është ndarë në dy grupe: - Grupi eksperimental (GE), me 110 nxënës dhe - Grupi i kontrollit (GK), me 110 nxënës. Me grupin eksperimental është zbatuar një program i veçantë stërvitor 12 javor. Në hulumtim përfshihen gjithsej 35 ndryshore. Në hapësirën antropometrike janë aplikuar 18 ndryshore, ndërsa në hapësirën motorike 17, duke përfshirë këtu edhe variablën e kriterit - Shtytja e gjyles. Autori i përshkruan të gjitha variablat veç e veç, të cilat janë të standardizuara dhe të aplikuara edhe më herët nga autorët e ndryshëm.

Sa i përket instrumenteve matëse të aplikuara gjatë realizimit të testimeve, përveç mjeteve bazike, janë përdorur edhe disa instrumente të teknologjisë së kohës së fundit, si: peshorja e modelit ( Tabita BC-545N), platforma "Contact mat" për matjen e kërcimeve, kohëmatësi digjital "Witty Timer ménages".

Të dhënat statistikore janë përpunuar me programin IBM SPSS Statistics 24 software: Analiza Deskriptive ka përfshirë: Mean (Mesi aritmetik), Min (rezultati minimal), Max (Rezultati maksimal), Std. Deviation (Devijimi standard), Skewness, Kourtosis. Analiza Komparative "Repeated measure Anova" ( Për të parë dallimin mes testeve fillestare dhe finale në grupin eksperimental dhe kontrollues (differences within subjects, MANOVA) dhe dallimin mes grupit kontrollues dhe eksperimental në testet fillestare dhe finale (differences between subjects ANCOVA)). Analiza e korelacionit (bivariate correlation) (Korelacioni mes variablave antropometrike dhe motorike dhe teknikës së shtytjes së gjyles). Analiza regressive (përcaktimet e ndikimit të sistemit të treguesve morfologjik dhe testeve motorike në ato kriterike). Analiza faktoriale (të dhënat deskriptive dhe mënyra e ekstrahimit apo shfaqjes së faktorëve latent te ndryshoret antropometrike dhe motorike).

Në **kapitullin e tretë** - autori ka paraqitur interpretimet e rezultateve deskriptive të hapsirës morfologjike dhe motorike ndërmjet grupit të kontrollit dhe grupit eksperimental, si në matjet para aplikimit të programit stërvitor, po ashtu edhe në matjet pas aplikimit të programit stërvitor. Përmes analizës komparative "repeated measure Anova" autori ka vërtetuar dallimet në mes të testeve fillestare dhe finale në grupin eksperimental dhe kontrollues (differences within subjects, MANOVA) dhe dallimet në mes të grupit kontrollues dhe eksperimental në testet fillestare dhe finale (differences between subjects ANCOVA). Gjithashtu në këtë kapitull janë përfshirë analiza e korelacionit ndërmjet variablave antropometrike dhe motorike

dhe teknikës së shtytjes së gjyles. Përmes analizës Regresive është bërë përcaktimi i ndikimit të sistemit të treguesve morfologjik dhe testeve motorike në ato kriterike. Për ekstrahimin e faktorëve latentë është aplikuar analiza faktoriale, përmes së cilës janë ekstrahuar 6 faktorë latent.

Në **Kapitullin e katërt** është paraqitur diskutimi i gjetjeve të hulumtimit, ku janë analizuar dallimet ndërmjet matjeve në kohë, dmth. matjeve të realizuara para aplikimit të programit dhe matjeve të realizuara pas aplikimit të programit stërvitor, si dhe dallimet ndërmjet grupeve, grupit eksperimental dhe grupit të kontrollit. Gjithashtu janë analizuar efektet e programit stërvitor në rritjen e performancës së shtytjes së gjyles, dhe rezultatet e këtij studimi janë krahasuar me gjetjet e autorëve të ndryshëm, si në hapësirën morfologjike ashtu edhe në atë motorike. Në fund të këtij kapitulli është shqyrtuar vërtetimi i hipotezave duke u bazuar në rezultatet e punimit.

Në përfundim të këtij disertacioni, autori në bazë të rezultateve të fituara bënë një përmbledhje të tërë punimit me përfundime dhe rekomandime për lexuesit.



## Përfundimi dhe propozimi i komisionit

Punimi i disertacionit të doktoraturës me titull: **Ndikimi i forcës eksplozive në efikasitetin e rezultateve në shtytjen e gjyles**, i kandidatit Mr.Sc. Agron Thaçi paraqet një hulumtim shkencor autentik në fushën e atletikës shkollore. Përmes analizave statistikore dhe rezultateve të fituara të këtij hulumtimi në lëmin e atletikës, jepet një kontribut shkencor për këtë kategori të nxënësve të moshës 16 vjeçare. Studimi ofron njohuri mbi efektin e veprimtarisë mësimore-eksperimentale dhe ndikimin e forcës eksplozive në rezultatet e shtytjes së gjyles. Përmes krahasimeve të grupeve dhe të matjeve në kohë është shpjeguar ndikimi i programit të zbatuar pliometrik 12 javorë në përmirësimin e ndryshoreve morfologjike dhe motorike dhe në efektet e rezultateve teknike të shtytjes së gjyles.

Sipas kësaj që u tha më lart: Komisioni për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull: **Ndikimi i forcës eksplozive në efikasitetin e rezultateve në shtytjen e gjyles**, të kandidatit Mr.Sc.Agron Thaçi, konstaton se ky punim i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara dhe i propozon Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës, që ta aprovoj këtë raport të vlerësimit të disertacionit të doktoraturës dhe të vazhdohet me hapat që vijojnë deri në mbrojtjen publike.

Tetovë, dhjetor 2020

Komisioni:

1. Prof.Dr. Fadil Rexhepi - kryetar

2. Prof.Dr. Hyjnor Kica - anëtar

3. Prof.Dr. Agron Ademi- anëtar

4. Prof.Dr. Haki Ismaili- anëtar

5. Doc.Dr. Astrit Iseni- anëtar

